National Albanian
Real Estate Association

NEWSLETTER

Nr.3/ Korrik - Shtator 2026

NAREA® në Vrojtimin Bazë 2026

Një profesion bëhet i besueshëm kur flet me një zë.

Gjetjet e Vrojtimit Bazë 2026, trajnerët e rinj, NAREA® në arenën ndërkombëtare dhe thirrja për ta çuar reformën deri në fund.

NË KËTË NUMËR

Studim Bazë i Sektorit të Pasurive të Paluajtshme.

Mediat pasqyrojnë Studimin Bazë kombëtar të NAREA®.

Train the Trainer - ToT.

Nga risqet e pastrimit të parave drejt integritetit të transaksionit.

NAREA® në Konferencën Ndërrajonale të CIPE në Jerevan, Armeni.

NAREA® në Forumin e International Chamber of Commerce in Albania.

Ligji njihet. Zbatimi mungon.

Studim Bazë i Sektorit të Pasurive të Paluajtshme.

Për herë të parë në Shqipëri: studimi bazë për sektorin e pasurive të paluajtshme.

Për herë të parë në Shqipëri u realizua një studim bazë për sektorin e pasurive të paluajtshme. ***NAREA®*** *ftoi agjentët, brokerët dhe drejtuesit e zyrave të pasurive të paluajtshme të plotësonin pyetësorin e studimit "****Forcimi i Profesionistit të Pasurive të Paluajtshme dhe Kuadrit Rregullator në Shqipëri****".*

Ata sollën përvojën dhe këndvështrimin e tyre profesional mbi tregun shqiptar.

Mediat pasqyrojnë Studimin Bazë kombëtar të NAREA®.

Nisma e ***NAREA®*** *për të analizuar sektorin e pasurive të paluajtshme u pasqyrua nga mediat kombëtare, të cilat informuan publikun për studimin e nisur nga shoqata. Kjo jehonë tregon interesin në rritje për zërin e profesionistëve të sektorit.*

Train the Trainer: Investimi tek njerëzit është investimi tek e ardhmja.

Mbyllëm me sukses sesionin tonë të katërt ToT, dedikuar profesionistëve që synojnë të bëhen trajnerët e ardhshëm të sektorit të Real Estate.

Nën drejtimin e trajnerit Zola Szerencses, pjesëmarrësit patën mundësinë të eksplorojnë teknika dhe metoda të ndryshme të komunikimit, prezantimit dhe përvetësimit të informacionit, duke e kthyer trajnimin në një eksperiencë sa profesionale, aq edhe njerëzore.

Ky është vetëm fillimi i një rrugëtimi të ri. Një rrugëtim që kërkon përkushtim, punë dhe vazhdimësi, por që është padyshim i arritshëm.

Nga risqet e pastrimit të parave drejt integritetit të transaksionit.

*Në kuadër të projektit **MATRA “Strengthening AML Knowledge, Oversight, and Professional Capacity in Albania**”, u zhvillua fokus grupi midis **NAREA®** dhe **IDM**.*

Diskutimet u përqëndruan te sfidat praktike në zbatimin e detyrimeve kundër pastrimit të parave (AML), identifikimi i riskut dhe evidentimi i sinjaleve të dyshimta. U theksua rëndësia e këtyre proceseve për sigurinë, integritetin e transaksioneve dhe besueshmërinë ndaj klientëve.

National Albanian Real Estate Association

SHTATOR 2026

NAREA® në Konferencën Ndërrajonale të CIPE në Jerevan, Armeni.

NAREA® *mori pjesë në konferencën ndërrajonale të* ***CIPE, "Building Economic Freedom & Resilience Through Cross-Regional Partnerships"****, zhvilluar në Jerevan, Armeni.*

Konferenca bashkoi organizata biznesi dhe të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor, Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore për të shkëmbyer praktika mbi advokimin, reformën ekonomike, forcimin institucional dhe qëndrueshmërinë organizative, si dhe për të krijuar partneritete të reja ndërrajonale.

NAREA® në Forumin e International Chamber of Commerce in Albania.

NAREA® *mori pjesë në forumin e organizuar nga International Chamber of Commerce in Albania, në bashkëpunim me Albania Investment Council, mbi forcimin e rolit të organizatave të biznesit në politikëbërje dhe rritjen e efektivitetit të advokimit.*

Gjatë forumit u prezantuan gjetjet e studimit "Supporting Stronger Business Organizations in Albania" dhe Udhëzuesi i Komunikimit për Organizatat e Biznesit. Si një nga 20 organizatat kontribuuese, ***NAREA®*** *solli perspektivën e sektorit të pasurive të paluajtshme, duke theksuar rëndësinë e një dialogu publik-privat që përkthehet në vendimmarrje më të mirë dhe më pranë realitetit të tregut.*

Ligji njihet. Zbatimi mungon.

4 në 10 agjentë realisht të formalizuar

15 rekomandime konkrete politikash

10 Indikator bazë monitorimi

***NAREA®** prezanton Vrojtimin Bazë 2026: "Nga Vlerësimi në Advokim", nga ligji te zbatimi real në tregun e pasurive të paluajtshme.*

*Më 21 shtator 2026, **NAREA® prezantoi gjetjet e Vrojtimit Bazë të Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme 2026.** Ky është vrojtimi i parë sistematik kombëtar që analizon strukturën, sfidat dhe prioritetet e reformës në profesionin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri.*

*Eventi u nderua nga pjesëmarrja e Zëvendësministres së Drejtësisë, **znj. Elona Hoxha**. Gjetjet u prezantuan nga autori i vrojtimit, eksperti **Dr. Zef Preci**. Në panel u diskutua me Kryetarin e Bordit të **NAREA®**, **z. Dritan Caka**, dhe me **z. Edval Zoto**, Menaxher Programi pranë **CIPE**.*

*Në sallë ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Autoriteti i Inteligjencës Financiare (AIF), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Këshilli i Evropës, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Bankat partnere të **NAREA®**. Morën pjesë gjithashtu anëtarë të Bordit, anëtarë të **NAREA®** dhe profesionistë që kontribuan duke plotësuar pyetësorin e vrojtimit.*

Ky raport i gjetjeve nuk është kundër reformës.
Është një thirrje për ta çuar reformën deri në fund.

National Albanian
Real Estate Association

Rreth NAREA®

***NAREA®** është zëri më me ndikim i profesionistëve të Real Estate në Shqipëri.*

***NAREA®** përfaqëson, mbron dhe zhvillon profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme, përmes advokimit ligjor, edukimit profesional, standardeve etike, bashkëpunimit me institucionet dhe të dhënave për tregun. **Qëllimi është një treg i formalizuar, transparent dhe i besueshëm**.*

***Vizioni 2030**: **NAREA®** të jetë pika e referencës në nivel kombëtar dhe rajonal për të dhëna, standarde, të besueshme dhe advokim me integritet në sektorin e pasurive të paluajtshme.*

***NAREA®** është markë tregtare e regjistruar dhe e mbrojtur, me të drejtë për tu përdorur vetëm nga anëtarët të licencuar dhe të verifikuar. Verifiko statusin në: narea.al/verifiko*

***Partneritete Strategjike**:*
***NAR** – National Association of REALTORS® (Washington, D.C., USA)* 🇺🇸
***CEPI** – European Association of Real Estate Professions (Bruksel, EU)* 🇪🇺

YourEdgeInRealEstate

Regjistrohu në databazën e NAREA® duke dërguar një e-mail në info@narea.al dhe merr i pari çdo numër të Newsletter-it.

© 2026 NAREA® – National Albanian Real Estate Association